



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore



Në bazë të nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtaret Publik Nr 08/L-197, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës r. 03/L-068, Nenit 8, paragrafi 3.1 të Rregullores (qrk) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe ëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet ublike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitars dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 ër Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të ërgjithshëm, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Pranuar - Prilaziti Me Datan 13-05-2025			
Nr. i Organiut Org. Bro	Nr. i Org. Bro	Shtetësi Patriot	Vlera Vrednost
62	111	Kos	h/h

Nr.	Institucioni edukativ	Vendi	Pozita	Vendi i lirë- kohëzgjatja	Numri i pozitive
1	Çerdhja " Gëzimi Ynë", Viti	Fshati Drobesh	Edukatore grupmosha 0-3	Vend i lirë - kohë të pa caktuar	2
			Edukatore grupmosha 3-6	Vend i lirë - kohë të pa caktuar	3
		Fshati Qifllak	Edukatore grupmosha 0-3	Vend i lirë - kohë të pa caktuar	1
			Edukatore, grupmosha 3-6	Vend i lirë - kohë të pa caktuar	1

Përshkrimi i shkurtër i detyrave të punës

- Promovojë zhvillimin tërësor, duke përfshirë edukimin, shëndetin dhe mirëqenien e çdo fëmije;
- Stimulojë zhvillimin fizik, kognitiv, gjuhësor, social, emocional dhe të personalitetit;
- Promovojë edukimin e bazuar në vlera që siguron zhvillimin e marrëdhënieve ndër-personale, aftësive ndërvepruese, vetëdijes dhe vetë rregullimit emocional të fëmijës.
- Ofrojë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të nxënë aktiv të fëmijës përmes lojës dhe të promovojë të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Sigurojë përfshirjen e këndvështrimit të fëmijës dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje, zhvillimin e përgjegjësisë për veten, të tjerët dhe mjedisin;
- Të krijojë kushte për identifikim dhe referim të nevojave dhe potencialeve të secilit fëmijë.
- Si dhe detyra tjera të dhëna nga drejtori/e i/e institucionit edukativ të bazuara në ligjet aktuale që mbulojnë fushën e edukimit.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Formulari i aplikimit, i plotësuar - merret në komunë Arhivë - shkarkohet nga Simbnj ose uebfaqja e komunës.
- Kopjet e dokumenteve personale (letërnjoftim ose pasaportë).
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati nëse ai/a jo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur).
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore (prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim).
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj - prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim).
- Kopjet e dëshmisë së punësimit - (nëse ka).
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike (prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim).
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit).
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve duke përfshirë licencën e mësimdhënësit nëse ka (nevojiten për vlerësimin e portfolios profesionale).
- Letër motivuese ose një ese personale të lidhur me mësimdhënien (nevojiten për vlerësimin e portfolios profesionale).
- Dëshmi për aktivitetet tjera në proceset e zhvillimit të arsimit apo mirënjohje etj, (nevojiten për vlerësimin e portfolios profesionale).

Vërejtje 1: Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e parapara sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ MASHTI nr.01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm:

Vlerësimi i kandidatëve:

1. Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
 - a) Testit me shkrim, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
 - b) Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm.

Vërejtje 2: Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Paraqitja e aplikacioneve: Aplikacionet i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arkivës apo të dërgohet me postë në këtë adresë: Komuna e Vitisë, Rr. Hasan Kabashi, pa nr. Viti. Konkursi dhe rezultatet shpallen web faqen <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkursey-njoftimet/konkurset/>

Konkursi është i hapur nga **14.05.2025 deri më 12.06.2025**

Konkursi publikohet në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe SIMBNJ.

Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Datë 13.05.2025

NjMBNJ
Hysen Ymeri

